



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË**

RAPORTI TEKNIK

**“HARTIMIN E STUDIM PROJEKTIMIT PËR OBJEKTET
E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE EDUKIMIT”**

**RIKONSTRUKSION I PJESSHEM I SHKOLLES
SE MESME TE PERGJITHSHME
“Andon Zako Çajupi”**

RAPORTI TEKNIK
INFORMACION I PERGJITHSHEM

- Hyrje

Programi i Arsimit Parauniversitar edhe Edukimitka në qendër të tij hartimin e politikave në përmirësimin e infrastrukturës arsimore dhe kushteve të mësimdhënies.

Politika e programit ka si qëllim prioritar, propozimin dhe hartimin e projekteve të Qeverisjes Vendore për ndërtimin e godinave të reja shkollore dhe parashkollore në të gjithë territorin e Tiranës të destinuar si sheshe të lira, për shkak të rritjes së demografisë dhe zhvillimit ekonomik e social duke synuar kështu rritjen e kapaciteteve të arsimit të përgjithshëm parashkollor e shkollor .

Për sa më sipër, objekti që trajtohet ne kete studim projektim është:

**STUDIM – PROJEKTIM
RIKONSTRUKSION I PJESSHËM E SHITESË AMBJENTESH NË
SHKOLLËN E MESME "ANDON Z. ÇAJUPI"**

Vendodhja e objektit

Zona ku do te ndertoht ndodhet brenda territorit administrativ te Bashkise Tirane, dhe me konkretisht ne Rrugen e "Kongresi i Manastirit", Njesia Administra Nr. 3.

Siperfaqja e marre ne studim ka nje forme te shtrire ne trajte L-je e orientuar me brinjen me te gjate ne drejtimin veri-lindje, dhe kufizohet:

Në veri me Rrugen "Kongresi i Manastirit"

Në lindje me objekte banimi

Në jug me objekte banimi

Në perëndim me objekte banimi

- **Pershkrimi i gjendjes aktuale te objektit**

Shkolla e Mesme “Andon Zako çajupi” është ndërtuar ne fundin e viteve '50, godina e saj eshte 3 kate ne formen e germes ”L”, pjeserisht me bodrum. Ashtu si tregohet ne detyren e projektimit kjo godine eshte e amortizuar dhe me ambiente te pamjaftueshem per kryerjen e procesit mesimor. Palestra egzistuese nuk i ploteson kushtet e siperfaqes dhe ambienteve ndihmese. Pervec kesaj korridoret jane 2.2m te gjere (kur duhet te jene minimumi 3m) dhe per te mos penguar levizjen ne to dyert e klasave hapen nga brenda gje qe eshte ne kundersizhtim me kushtet teknike te levizjes ne raste emergjencash. Ne projekt parashikohet rikonstruksioni i objektit ekzistues dhe shtese.

Pamje te gjendjes ekzistuese te shkolles




Fig.1

Pamje te gjendjes ekzistuese te oborrit te shkolles



Fig.2

Pamje te gjendjes ekzistuese te ambienteve te brendshme te shkolles



PUNIMET QE JANE REALIZUAR

RAPORTI TEKNIK

Projekt - Zbatimi i rikonstruksionit te shkolles se mesme “Andon Zako Çajupi” eshte hartuar mbi bazen e projekt idese se miratuar nga Keshilli Teknik i Bashkise Tirane.

Ne Projekt Zbatim jane rreflektuar te gjitha verejetet dhe sugjerimet e bera nga anetaret e Keshillit Teknik dhe specialistet perkates.

Projekt Zbatimit perfundimtar i objektit, perbehet nga nenprojektet:

A – PROJEKTI ARKITEKTONIK

(A.0-01)	Planvendosja e shkolles
(A.0-02)	Plan sistemimi
(A.0-03)	Plani i Kantierit
(A.0-04)	Plani i Piketimit
(A.0-05)	Plani i rilevimit
(A.0-06)-(A.0-09)	Plani i katit perdhe , pare ,dyte ,fasada ekzistuse
(A.1-01)-(A.1-06)	Plane te katit perdhe,pare,dyte me dimesionim ,mobilim.
(A.1-07)	Plani i tarraces
(A.2-01)	Prerjet me detajet
(A.2-03)	Fasadat
(A.3-01)	Pamje te dyerve dhe plane te kateve
(A.3-02)	Pamje te dritareve dhe plane te kateve
(A.4-01)	Pamje ne prespektive

B – PROJEKTI KONSTRUKTIV

(K.0-01) - (K.1-11)	Plani i nderhyrjeve ne murature, dysheme dhe nderkate
---------------------	---

<i>(K.1-01) - (K.1-13)</i>	<i>Plani i Themeleve, Mureve lidhes, Kolonave, Strukturave & detaje te trareve lidhes tye themeleve</i>
<i>(K.2-01) - (K.2-03)</i>	<i>Armimi i Trareve te Themeleve</i>
<i>(K.3-01) - (K.3-02)</i>	<i>Armimi i Kolonave</i>
<i>(K.3-03) - (K.3-04)</i>	<i>Armimi i shkalles se podrumit, shkalles shtese & plintit. Muri mbajtes per platformen, armimi i soletes monolite dhe trareve perkates</i>
<i>(K.4-01) - (K.4-12)</i>	<i>Armimi i Trareve</i>
<i>(K.5-01) - (K.5-07)</i>	<i>Armimi i Soletes, Detaje solete, tarace dhe ulluku</i>
<i>(K.6-01) - (K.6-03)</i>	<i>Mbulesa e Palestres</i>
<i>(K.7-01)</i>	<i>Shkalla metalike e emergjences</i>
<i>(K.8-01) - (K.8-03)</i>	<i>Detate teknike te shteses (korridorit) mbi godinen ekzistuese</i>

C – PROJEKTI ELEKTRIK

<i>(E.1-01)- (E.1-03)</i>	<i>Sistemi i shperndarjes se fuqise .Planimetria e ndricimit te katit perdhe,pare ,dye.</i>
<i>(E.2-01)- (E.2-03)</i>	<i>Sistemi i shperndarjes se fuqise .Planimetria e prizave te katit perdhe,pare ,dye.</i>
<i>(E.3-01)- (E.3-03)</i>	<i>Sistemi i shperndarjes se fuqise .Planimetria e instalimeve internet , telefoni, tv te katit perdhe,pare ,dye.</i>
<i>(E.4-01)- (E.4-03)</i>	<i>Sistemi i shperndarjes se fuqise .Planimetria e instalimeve CCTV dhe Lajmerimit publik te katit perdhe,pare ,dye.</i>
<i>(E.5-01)</i>	<i>Sistemi i shperndarjes se fuqise .Planimetria e instalimeve te rrjeteve te mbrojtjes atmosferike.Plani i tarraces.</i>
<i>(E.6-01) - (E.6-02)</i>	<i>Sistemi i shperndarjes se fuqise .Planimetria e instalimeve te rrjeteve te mbrojtjes atmosferike.Plani i tarraces.</i>

<i>(M.1-01) - (M.1-03)</i>	<i>Impianti i mbrojtjes kundrra zjarrit .Planimetrite e katit perdhe ,pare,dyte.</i>
<i>(M.2-01) - (M.2-04)</i>	<i>Impianti i mbrojtjes kundrra zjarrit .Planimetrite e katit perdhe ,pare,dyte.</i>

*Projekti Zbatimi eshte shoqeruar me Raportin Teknik, Specifikimet
Teknike dhe Preventivin e Punimeve te hartuar me çmimet e VKM Nr.407
date 27.06.2012.*



PROJEKTI ARKITEKTONIK

Pershkrimi i nderhyrjes per rikonstruksionin

Grupi i projektimit pas vizites ne objekt dhe analizes qe i beri gjendjes ekzistuese mbeshtetur dhe ne kerkesat e detyres se projektimit pa te pershtatshem ta orientoje punen per rikonstruksionin e objektit ne keto drejtime:

1. Shtimi i siperfaqeve te godines ekzistuese, ndertimin e nje palestres te re ne fushen e basketbollit te shkolles, permiresimi i kushteve ne te dhe rikonstruktimi i fasades.
2. Sistemimi i territorit gjelberimi i ambjenteve te jashtme dhe sistemimi i hapësirave sportive te hapura.

Per piken e pare.

Duke pasur parasysh problematiken e palestres egzistuese dhe kekrsave te detyres se projektimit, meqenese konstruksioni ekzistues nuk eshte parashikuar te ngarkohet dhe me dy kate te tjera (te nevojshme per ambientet e reja), grupi i projektimit vendosi shembjen e palestres egzistuese dhe rindertimin ne te njejtin ambjent ne nje format me 3 kate ne te cilat parashikohet te ndertohen labororet dhe klasa dhe gjithashtu me deren e vecuar per nga sistemimi edhe dhomen e kaldajes. Palestra e re pozicionohet ne pjesen e perparme te oborrit te shkolles (ne fushen e minifutbollit) duke lene bosh hapsirat e perparme te oborrit per funksione te tipit mesimor hapsira e rreshtimit dhe hapësira e rikreacionit (gjate orareve te pushimit).

Per piken e dyte

Me vendosjen e palestres ne pjesen e perparme kemi mundesine per te lene hapsira gjera per zgjidhjen e hapësirave te gjelberuara te shkolles. Keto hapësira pozicionohen ne pjesen perimetrale te shkolles me nje grup kryesor, qe ndodhet ne te majte te hyrjes kryesore ne objekt (ne veri te palestres) i cili sherben si nje lulishte jo vetem per femijet e shkolles po dhe per komunitetin. Nje grup ne pjesen e perparme te shkolles (ne te dy krahet e hyrjes) qe perbehet nga 2 rripa te gjelberuar (ne te dy krahet e hyrjes) te mbjelle me gjelberim te ulet per te mos bllokuar pamjen e fasades kryesore dhe 2 hapësira te tjera perbelle ne perimenter te murit rrethues te cilat mbillen me gjeleberim te larte per kryer hijezimin dhe per ti dhene sa me shum privatesi oborrit nga ndertesat e banimit qe e rrethojne. Ne pjesen e pasme mbahet hapsira egzistuese duke u zgjeruar dhe sistemuar me bime te larta te cilat krijojne nje hapsire te gjelberuar pushimi. Fushat ne pjesen e tme te objektit jane spostuar ne perimenter te murit rrethues per te lene hapsire kalimi midis fushave dhe shkolles ne te cilen eshte parashikuar nje rrip

RAPORTI TEKNIK

tjeter i gjelberuar me bimesi te larte e cila dhe mbyll perimewtrin e levizjes perreth objektit.

- **Zgjidhja funksionale**

Sipas formes se re objekti do te kete keto funksione ne kate :

Ne katin nentoke (i ndertuar rishtasi) lihen funksionet e dhomes se kaldajes depozites se peletit(ne funksion te kaldajes)dhe dhoma teknike per stafin e shkolles. Shkallet e keti ambjenti komunikojne drejt per se drejti me pjesen e jashtme te oborrit per arsye te sigurise kunder zjarrit.

Ne katin perdhe eshte vendosur holli kryesor.

Holli kryesor i shkolles i vendosur ne qender te godines ka dy hyrje qe sherbejne per lidhjen e shkolles me oborin e perparme, ai eshte konceptuar qe te jete i lirshem dhe i bollshem. Holli mendohet si nje hapësire e vetme dhe do te sherbeje jo vetem si nje vend grumbullimi e qarkullimi, por dhe si nje hapësire e lirshme ekspozimi te puneve te nxenesve duke qene se eshte i pershkrueshem gjate gjithë periudhes kohore te funksionimit te shkolles.

Ne vazhdimesi te hollit sipas ksaj rradhe kemi ne te majte barin zyren e psikologutnje klase, NHS dhe shkallet qe te ngjisin ne katin e siperm. Ne pjesen jug- perendimore te ketij kati kemi te rreshtuara klasat, 4 ne secilin krah te shkalles qendrore. Ne zonen e ish palestres e cila aksesohet nepermjet nje koridori ne krahun e majte te objektit ne kete shtese pervec kalimit per ne sallat polifunksionale kemi te organizuara edhe laboratore te cilat kane te parashikuar ndricimin e mire dhe ajrosjen, po ashtu dhe kushtet optimale sipas manualit per zwillimin e oreve laboratorike si hapsira magazinimi, tavolina pune te specializuara (sipas lendes), etj.

Ne katin e pare ne vendin e hyjes kemi sallën e mesuesve e cila komunikon me pensulinen duke e bere ate te shfrytezueshme ne formen e nje tarrace. Ne krahun e majte te salles se mesuesve ndodhet drejtoria, sekretaria, NHS dhe pjesa tjeter eshte klasa dhe laboratore.

Me katin e dyte, zyren e drejtorise e zevendesojne nendrejtoria dhe arkiva e shkolles, ne shtesen (ne te cilen ka qene ish palestra) eshte akomoduar edhe biblioteka.

KOEFICIENTET TEKNIK

SIPERFAQE E SHESHIT	5385 m ²
---------------------	---------------------

RAPORTI TEKNIK

SIPERFAQE E SHFRYTEZUAR PER NDERTIM	1820 m ²
KOEFICIENTI I SHFRYTEZIMIT TE TERRITORIT	0.33

SIPERFAQE E GJELBERUAR	643m ²
SIPERFAQE SHESHE TE SHTRUARA	2400m ²
TERRENE SPORTIVE	522m ²

SIPERFAQE NDERTIMORE TE KATIT PERDHE

AMBIENTET	SIP. QE RIKONSTR.	SIP. QE SHTOHET	GJITHSEJ
HOLL KORIDOR + SHKALLE	434 m ²	15 m ²	449 m ²
KLASA	346 m ²	95.9 m ²	441.9 m ²
Bar+fast-food	25m ²	-	25 m ²
TUALET	36.6m ²	-	36.6m ²
PALESTRA	-	474m ²	474m ²
PSIKOLOG	11.8 m ²	-	11.8 m ²
DENTIST	12 m ²	-	12m ²
NDIHMA E PARE	12m ²	-	12m ²
QENDRA E ZERIT	5.9m ²	-	5.9m ²
DHOMA E ROJES	5.6m ²	-	5.6m ²
N.H.S.	71.6m ²	-	71.6m ²
DHOME TEKNIKE (kaldaja)	-	61.6 m ²	61.6m ²
SALLE POLIFUNKSIONALE	116.5 m ²	-	116.5 m ²
SIPERFAQE E KATIT	1172 m²	648m²	1830m²

SIPERFAQE NDERTIMORE TE KATIT TE PARE

AMBIENTET	SIP. QE RIKONSTR.	SIP. QE SHTOHET	GJITHSEJ
HOLL KORIDOR + SHKALLE	434 m ²	15 m ²	449 m ²
KLASA	385 m ²	148.4 m ²	533.4 m ²
SALLA E MESUESVE	49.4 m ²	-	49.4 m ²
DREJTORIA	29.9 m ²	-	29.9 m ²
SEKRETARIA	12 m ²	-	12 m ²
BIBLIOTEKA	116.5 m ²	-	116.5 m ²
N.H.S.	71.6 m ²	-	71.6 m ²
SIPERFAQE E KATIT	1172 m²	174m²	1274.1m²

SIPERFAQE NDERTIMORE TE KATIT TE DYTE

AMBIENTET	SIP. QE RIKONSTR.	SIP. QE SHTOHET	GJITHSEJ
HOLL KORIDOR + SHKALLE	434 m ²	15 m ²	449 m ²
KLASA	588 m ²	264	852 m ²
N/DREJTOR	15 m ²	-	15 m ²
ASHIVA	15.1 m ²	-	15.1 m ²
TUALET	47.7 m ²	-	47.7 m ²
SIPERFAQE E KATIT	1172 m²	174 m²	1274.1 m²